

Të dashur struganë,

Prej ditës që kam shpallur kandidaturën për të qënë kryetar i Komunës së Strugës jeta ime ka ndryshuar vetëm në një aspekt. I mësuar si aktivist prej shumë vitesh, puna në terren është kthyer prej kohësh në mënyrë jetese për mua, ndaj takimet me njerëzit nuk janë asgjë e re, por ndryshimi dhe befasia më e madhe është reagimi i tyre i cili ka tejkaluar të gjitha pritshmëritë e mia!

Entuziasmi dhe energjia të cilën po ndesh tek ta është e jashtëzakonshme! Dëshira për të ndërtuar një realitet të ri, gatishmëria e caq shumë personave nga qyteti e deri në fshatin më të largët, është aq e madhe sa mund ta përkufizoj si Fenomenale!

Gjithë jetën time kam punuar pas kuintave, i jam larguar vendeve të para se kam qënë i zënë duke punuar në terren, aty ku gjithnjë ka pasur nevojë. Tani që kandidoj, që mora hapin të dalë ballazi në këtë sfidë të jetës, nuk e kisha menduar kurrë që do të kisha këtë mbështetje që po shoh!

Ndaj Faleminderit të gjithëve që po ma bëjnë këtë kandidaturë më të fortë e gjithëpërfshirëse! Çdo njeriu, prej atyre që kam pasur vetëm një përshëndetje e sot ndalojnë e më thonë se janë me mua në këtë rrugëtim, e deri tek ata që janë futur punës e kanë bashkuar forcat e tyre me mua, ju jam Mirënjohës!

Sa mirë të kem këtë mundësi për të punuar me Njerëzit e Mrekullueshëm që Struga ka e të ringjallim frymën e këtij qyteti, që është nga më të njohurit në të gjithë rajonin. Secilit strugan që po lexon këto rreshta, që ka lindur në qendër të qytetit apo në fshatin më të largët, pa dallim fetar, etnik apo partiak, secilit i them se ky është mision mbi çdo politikë!

Struga duhet dhe do të shkëlqejë përsëri sepse STRUGA JE TI!

Çdo personi nga mijërat që kam takuar këto ditë, ju them: FALEMINDERIT!

Singerisht  
Idri Istrefi



**KËSHILLI I KOMUNËS SË STRUGËS**  
**LISTA E KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË NGA KOALICIONI**  
**ALEANCA PËR SHQIPTARËT DHE ALTERNATIVA**

---

- |                           |                     |                      |
|---------------------------|---------------------|----------------------|
| 1. Nijazi Xhumkar         | 10. Vlora Sula      | 19. Selamije Hoxha   |
| 2. Safet Demiralijeski    | 11. Dritan Reçi     | 20. Nuri Alla        |
| 3. Premtime Zylali Deliaj | 12. Alil Roçi       | 21. Edlira Dervishi  |
| 4. Argent Alasani         | 13. Sajmira Saliu   | 22. Alma Polisi      |
| 5. Asim Saitoski          | 14. Amir Murtezoski | 23. Ramis Qira       |
| 6. Jasmina Canoska        | 15. Fortuna Bajrami | 24. Djellza Gazaferi |
| 7. Kujtesa Kaliqi         | 16. Besa Sela       | 25. Shkëlqim Aliu    |
| 8. Faton Musai            | 17. Rami Sinani     | 26. Aqif Ajro        |
| 9. Emin Kupa              | 18. Nijazi Kerim    | 27. Feruz Sadiku     |

Të dashur qytetarë,

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa tanimë është dëshmuar si e ardhmja politike dhe shpresa e vetme e shqiptarëve, së fundmi me betejën e fituar bashkë me ju për t'i dhënë fund pashtetësisë si një diskriminim anakronik që i prekte më së shumti shqiptarët.

Por ne besojmë se komuna është më shumë se kurrë motori i ambicies demokratike, i avancimit të shtetit të së drejtës, i barazisë së qytetarëve para ligjit dhe i zbatimit të tij pa diskriminime, si dhe i pjesëmarrjes qytetare në menaxhimin e publikes.

Megjithatë, korrupsioni i lartë i politikanëve të partive që tradicionalisht kanë udhëhequr me vendin në dy dekadat e kaluara, korrupsion ky që është endemik dhe i përhapur në çdo sferë të jetës shoqërore, ka dëmtuar në masë të madhe besimin e qytetarëve ndaj politikës dhe çështjeve publike. Duke qenë se fuqizimi i nivelit lokal është pjesë e ADN-në së koalicionit tonë, dëshmuar në qeverisjet tona të deritanishme komunale, ne konsiderojmë si urgjent rikthimin e besimit të qytetarëve në politikën, në veçanti në komunë, si nivelin më i afërt me brengat e përditshme të qytetarëve.

Andaj, të gjitha propozimet tona kanë për qëllim avancimin e qeverisjes së mirë dhe etikës në politikë, si dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm mbi atë individual dhe partiak, për t'i mundësuar secilit qytetar dhe secilës qytetare më tepër mirëqenie dhe më tepër përfshirje aktive në jetën politike të komunës.

Vizioni ynë për vetëqeverisjen lokale, nga Likova deri në Strugë, është rritja e investimeve në kapitalin tonë mjedisor dhe atë njerëzor, duke u përqendruar në këto prioritete: mjedisi, arsimiti, shëndetësia, mbrojtja sociale, kultura dhe sporti. Prioritet tjetër thelbësor për ne është rritja ekonomike lokale duke u kloncentruar në faktorët kryesorë që ndikojnë në dinamikën ekonomike dhe tregtare të një komune, siç janë mobiliteti, politika tatimore, mbrojtja e mjedisit, planifikimi hapësinor apo rritja e investimeve në infrastrukturën bazike. Prioritete të veçanta do të kenë rritja e konektivitetit lokal dhe atij rajonal, si dhe avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës lokale, veçanërisht sa i përket ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.

Andaj, të vazhdojmë rrugëtimin tonë të përbashkët "slogani", që çdo qytet, çdo lagje dhe çdo fshat të menaxhohet me plan dhe përgjegjësi, bashkë me ju dhe për ju.

Aleanca për Shqiptarët



Ziadin Sela, kryetar



AlternAtiva



Afrim Gashi, kryetar

## Parimet e qeverisjes komunale

Masat e propozuara në programin tonë nuk janë medoemos përgjegjësi direkte e autoriteteve lokale, por ato pasqyrojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe koherente politikat që Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa synon të zbatojë në nivelin lokal, bazuar në programin tonë të përgjithshëm komunal 2021-2025 i dalë si rezultat i një procesi disamujor i reflektimit të departamenteve të Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, me mbështetjen e qendrave të tyre analitike dhe të përfaqësuesve të tyre të zgjedhur

Ne besojmë se decentralizimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i komunave tona varet në masë të madhe edhe nga politikat dhe infrastruktura rregullative në nivelin qendror. Ne do të vazhdojmë të ndjekim dhe të shtymë disa prioritete horizontale të identifikuar në programin tonë qendror “Shtet për të Gjithë” 2020-2024. Këto prioritete kanë të bëjnë me parakushtet themelore për një vetëqeverisje lokale efikase, efiçiente dhe në shërbim të qytetarëve në nivelin lokal, me synim të ofrimit të një shërbimi cilësor dhe të barabartë për të gjithë.

Andaj, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të vazhdojë të angazhohet për një model të mirëfilltë decentralizimi që i jep fund politikës së shantazhimit dhe të kushtëzimit të komunave nga niveli qendror përmes sistemit të donacioneve të kapitalit, duke synuar që të ardhurat e komunave nga 15,7% sa janë tani, të arrijnë në 30% të ardhurave të përgjithshme publike, për të mundësuar autonomi fiskale të qëndrueshme për vetëqeverisjen lokale.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa angazhohet për transparencë, llogaridhënie, pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje, mbështetje të shoqërisë civile lokale, forcim të solidaritetit, qeverisje të mirë dhe me zero tolerancë ndaj korrupsionit, efikasitet dhe cilësi të shërbimeve komunale, si dhe promovim të projekteve inovative dhe të qëndrueshme, për një vetëqeverisje lokale efikase dhe efiçiente, e cila plotëson nevojat dhe pritjet e qytetarëve.

Mbrojtja e interesit të përgjithshëm, ndershmëria dhe transparenca në ushtrimin e funksionit publik janë lajtmotivi apo elementet thelbësore të koalicionit sonë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa është dëshmuar në qeverisje lokale si një forcë ku angazhimi i përfaqësuesve politikë të saj është bazuar në bindje dhe parime dhe ku ka mbizotëruar publikja mbi interesat individuale, duke siguruar kështu qeverisje të mirë dhe zhdukje të konflikteve të interesit dhe korrupsionit.

Ne do të fokusohemi në forcimin e strukturës institucionale lokale, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve për qytetarët në çdo sferë të përgjegjësisë së komunave. Koalicioni ynë angazhohet për zbatimin e parimit të subsidiaritetit të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton se autoritetet lokale duhet të jenë niveli i privilegjuar i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave publike, përderisa nuk është vërtetuar që një nivel më i lartë pushteti do të ishte më efektiv. Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektshmërisë së shërbimeve komunale, do të promovojmë zbatimin e modelit të qeverisjes ndër-komunale, krahas forcimit të rajoneve planore dhe rritjes së bashkëpunimit mes tyre dhe komunave.

## **Prioritetet tona**

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe AlternativA kanë vendosur që t'i bashkojnë forcat e tyre për të ofruar një program gjithëpërfshirës, inkluziv, përmbajtjesor dhe objektivist të realizueshëm, i cili propozon zgjidhje konkrete për të gjitha problemet me të cilat përballen komunat tona në fushat e tyre të përgjegjësisë të përcaktuara me ligj.

Programi ynë i përgjithshëm komunal 2021-2025 është korniza strategjike e cila do të orientojë qeverisjen tonë në çdo komunë me të cilën do të udhëheqim gjatë mandatit të ardhshëm. Ai ndahet në 5 shtylla si në vijim.

### **1. Komuna e qeverisur mirë dhe me demokraci pjesëmarrëse**

Prioritetet tona kryesore janë transparenca, llogaridhënia, demokracia pjesëmarrëse dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, mbështetja e shoqërisë civile lokale, qeverisja e mirë dhe tolerancë zero ndaj korrupsionit, efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve komunale, decentralizimi i mëtejshëm dhe bashkëpunimi ndërkomunal, si dhe promovimi i projekteve inovative dhe të qëndrueshme për të bërë jetën komunale më dinamike.

### **2. Administrata komunale efikase, moderne dhe në shërbim të qytetarëve**

Misioni parësor i komunës është përmbushja e nevojave të qytetarëve, përmes shërbimeve cilësore, posaçërisht të shërbimeve administrative dhe atyre të karakterit publik. Ne angazhohemi për shërbime komunale cilësore për të gjithë, transformim digjital dhe siguri në çdo cep të komunës.

### **3. Komuna e mirëqenies për të gjithë**

Prioriteti kryesor në këtë fushë është rritja e investimeve publike në kapitalin tonë mjedisor dhe atë njerëzor, duke u përqendruar në këto prioritetet: mjedisi, arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale dhe politikat inkluzive, kultura dhe sporti.

### **4. Komuna me zhvillim të qëndrueshëm lokal**

Shëndeti ekonomik i një komune matet për nga krijimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Nëse i forcojmë NVM-të, do ta dinamizojmë edhe rritjen ekonomike lokale. Por kjo nuk mjafton pa u adresuar edhe një sërë faktorësh tjerë siç janë politikat tatimore, mbrojtja e mjedisit, planifikimi hapësinor dhe rritja e investimeve në turizëm. Të gjitha këto së bashku përbëjnë vizionin tonë për një komunë me zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim.

### **5. Komuna me rend dhe plan në çdo cep**

Ne do të përqendrohemi në adresimin e pabarazisë në sektorët e mobilitetit, rrugëve, infrastrukturës komunale, planifikimit hapësinor, tokës ndërtimore, urbanizimit, banimit të qëndrueshëm dhe energjisë. Prioritete të veçanta do të kenë rritja e konektivitetit lokal dhe atij rajonal, si dhe avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës lokale, veçanërisht sa i përket ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.

## 10 zotime për Strugën

1. REVISION TOTAL - skanimi i të gjitha punimeve të bëra nga qeverisja aktuale lokale, duke zbardhur keqpërdorimet dhe veprimi sipas ligjit, fillimisht përmes revizionit të brendshëm dhe atij të jashtëm, qoftë shtetëror apo privat. Keqpërdorimet duhet të marrin fund përgjithmonë.
2. STUDIM TRAFIKU nga kompani e licensuar në këtë fushë. Studimi zgjat të paktën 6 muaj dhe pastaj bëhet plani se si duhet të zhvillohet komunikacioni në qytetin e Strugës. Me këtë do të kemi zgjidhje afatgjate të problemit me trafikun dhe kaosin në komunikacion. Studimi do të fillojë brenda 100 ditëve të para të qeverisjes sonë.
3. TRANSPARENCË NË MENAXHIM ME KOMUNËN – Komuna e Strugës është ndër komunat me jotransparente në territorin e Maqedonisë së Veriut. Nën drejtimin tonë, do të bëhet publik çdo harxhim në ueb faqe, në rrjetet sociale si dhe në mediat e vendit. Qytetarët do të kenë qasje direkte në krijimin e politikave lokale dhe të buxhetit komunal.
4. NDËRTIMI I BULEVARDIT LINDOR – Lidhja me rrugë të asfaltuar me 4 korsi, me trotuare dhe shteg për biçikleta, nga rruga e plazhit (Partizanja) deri tek rruga magjistrale. Tek rruga magjistrale do të lidhet me rrethrotullim, ndërsa fillimi i bulevardit do të jetë nga rrethrotullimi tek varrezat muslimane. Punimet në këtë bulevard do të fillojnë brenda vitit të parë të qeverisjes. Me këtë do të hapet mundësia edhe për projektimin edhe të rrugës nga magjistranja deri në fshatin Morovishtë.
5. ZGJERIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT – Përfundimi i punimeve për rrjetin primar dhe sekundar si dhe vënia në funksion të rrjeteve të kanalizimit në fshatrat Dollogozhdë, Koroshtishtë, Livadhi, Bixhovë, Frëngovë, Vranisht dhe Llozhan. Projektim dhe përgatitje e dokumentacionit teknik për rrjete kanalizimi në fshatrat e papërfshira në rrjet si: Tatesh i Epërm, Tatesh i Poshtëm, Novosellë – Bixhovë, Draslajcë, Radozhdë, Shum, Zagraçan, Belicë e Poshtme, Llabunishtë, Oktis, Podgorcë. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në vendbanimet të cilat pjesërisht janë të përfshira në rrjetin e Kanalizimit, si në Llabunishtë, Veleshtë, Ladorisht, Mislëshovë dhe në pjesë të reja të qytetit.
6. GJELBËRIMI I QYTETIT DHE VENDBANIMEVE PËRRETH, PARQE TË REJA DHE HAPËSIRA PËR REKREACION – Brenda 4 viteve do të mbjellim 1000 pemë të reja në hapësirat urbane, ndërsa pemë do të mbjellim në çdo vendbanim të Strugës. Do të krijojmë hapësira të reja të gjelbërta nëpër qytet, përfshirë këtu parqe të reja në të paktën tre pika kyçe në qytet si dhe një park për sport dhe rekreacion në hapësirën përballë stadiumit të hendbollit, pranë Plazhit të Femrave.
7. ZGJIDHJE AFATGJATE PËR DEPONINË E EGËR TË QYTETIT SI DHE DEPONITË E EGRA NËPËR VENDBANIMET E KOMUNËS – Do të ndërtohet një landfilli rajonal, i cili do të zgjidhë problemin e mbeturinave në shumicën e komunave në rajonin jugperëndimor.
8. ÇERDHE TË RE NË QYTET DHE NDËRTIMI I ÇERDHEVE LOKALE NË VENDBANIMET MË TË MËDHA TË KOMUNËS – Do të bëjmë zgjerimin e hapësirave ekzistuese si dhe ndërtimin e një objekti të ri në qytet, si dhe hapje të çerdheve lokale në disa vendbanime, përfshirë Llabunishtën, Veleshtën, Draslajcën, Dollogozhdën dhe Ladorishtin.
9. STRATEGJI AFATGJATE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT – Brenda administratës lokale do të krijohet Sektor në fushën e turizmit, me kuadër profesional dhe të trajnuar. Struga do të shndërrohet në destinacion turistik për çdo periudhë të vitit dhe jo vetëm gjatë verës. Do të subvencionohen turizmi malor dhe agro-turizmi. Komuna do të kryejë investimet e nevojshme infrastrukturore (rrugë, ujë, kanalizime) për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit.

10. ZGJIDHJE AFATGJATE PËR PROBLEMIN ME UJIN PËR PIJE – Do të bëjmë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, duke sanuar defektet e rrjetit që shkaktojnë humbje uji. Do të ndërrojmë gypat e asbestit në gjithë gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit, ndërsa do të shtojmë pompa në vendet ku presioni i ujit është i ulët. Do të bëhet studim fizibiliteti ujësjellësin në gjithë territorin e Komunës së Strugës.

11. NJËSI DINJITOZE ZJARRFIKËSISH – Përfundimisht do të zgjidhim problemin e kahmotshëm të Njesisë së Zjarrfikësve, duke siguruar mjete bashkëkohore, kamionë të rinj, veshje adekuate për zjarrfikësit, si dhe trajnime të vazhdueshme për të punësuarit në këtë njësi.

## **Back cover**

Përmbajtja :

1. foto e kandidatit për kryetar me qytetarë
2. Kontaktet dhe linku për të faqja e përgjithshme e fushatës ku do të gjindet programi i përgjithshëm lokal etj
3. barcode që të dërgon në faqen e kandidatit (me ndonjë mesazh të llojit ruaj natyrën, mos shtyp leter + emoji të reciklimin)